

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Nëse nuk të telefonoj më... të dua", 25 vite nga 11 Shtatori, mesazhi i fundit i një pasagjeri për bashkës horten para përplasjes me kullat binjake
ADRESA	https://www.gazetatema.net/lifestyle/nese-nuk-te-telefonoj-me-te-dua-25-vite-nga-11-shtatori-mesazhi-i-fund-i585422
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 13:45:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 14:22:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b02d0d7f9ce38480cd55ea7950d329516428411e6682afb3b951c699133ec469
TEKSTI	b73c9b3f9766f2f24ab445834e331e7aa17de6a513899e78cba959c1f181b3a4
PAMJA	46e53895160cc607da6a7b3a1ed9c5576d0b1f2d1b88fa5a8191861456ad4ce7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1665212b31944adb071bca04487efe74abc8bea2cfb8577766d592055f97911f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1665212b31944adb071bca04487efe74abc8bea2cfb8577766d592055f97911f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1e Hoxha: Partneriteti me SHBA, i qendrueshëm dhe i ndërtuar mbi vlera e interesa të përbashkëtaMinistri Salla: Siguria ushqimore e fëmijëve, pa kompromis, AKU intensifikon kontrollet me nisje fundit

“Nëse nuk të telefonoj më... të dua”, 25 vite nga 11 Shtatori, mesazhi i fundit i një pasagjeri për bashkëshorten para përplasjes me kullat binjake

11 Shtator 2026, 16:22Lifestyle TEMA



“Nëse nuk të telefonoj më... të dua”, 25

Një ditë që ndryshoi përgjithmonë Amerikën dhe la një plagë të thellë në kujtesën e botës. Më 11 shtator 2001, Shtetet e Bashkuara u përballën me një prej sulmeve terroriste më tronditëse në historinë moderne, që i mori jetën 2.977 njerëzve.

Katër avionë të rrëmbyer u kthyen atë mëngjes në mjete të një tragjedie që do të ndryshonte rrjedhën e historisë. Dy prej tyre u përplasën me kullat binjake të Qendrës Botërore të Tregtisë në Nju Jork, një tjetër goditi Pentagonin në Uashington, ndërsa i katërti, United Airlines Flight 93, u rrëzua në një fushë në Pensilvani pasi pasagjerët tentuan të marrin kontrollin e avionit.

Mes mijëra historive të asaj dite, disa prej tyre kanë mbetur të gjalla jo për shkak të pamjeve të tragjedisë, por fjalët e fundit që njerëzit arritën t'u linin atyre që donin.

Një prej tyre është historia e Brian Sweeney. Ai ndodhej në bordin e Flight 175 të United Airlines, avionit që u përplas me Kullën Jugore të Qendrës Botërore të Tregtisë.

Në momentet e para të rrëmbimit, ai arriti të telefononte bashkëshorten e tij, Julie. Ajo nuk mundi t'i përgjigjej telefonit. Në vend të një bisede, Brian la një mesazh zanor.

Në mesazh, Brian nuk foli gjatë për atë që po ndodhte, por i tregoi asaj se sa shumë e donte dhe që nëse nuk arrinte të mbijetonte atëhere i la asaj “amanet” që të kishte një jetë të lumtur dhe të jetonte mirë.

"Jules, jam Brian. Dëgjo, avioni im është rrëmbyer. Nëse gjërat nuk shkojnë mirë, dhe nuk duket mirë, thjesht dua të të them se të dua shumë. Shpresoj të të thërras sërisht, por nëse jo, jeto një jetë të mirë. Dua të argëtohesh sa më shumë, të njëjtën gjë edhe për prindërit e mi dhe të gjithë të tjerët. Unë thjesht të dua shumë... shihemi kur të vish këtu. Paqë ditë të bukura, foshnjë. Shpresoj të të thërras. Mirupafshim.", ishte ky mesazhi që i la ai dashurisë së tij të jetës.

Fjalët e Brian Sweeney-t kanë mbetur ndër dëshmitë më prekëse të 11 Shtatorit, sepse përtej frikës dhe kaosit të atij mëngjesi, ato tregojnë diçka dhe më njerëzore, ku në çastin kur gjithçka tjetër po humbiste kuptimin, ai zgjodhi të sigurohej që gruaja e tij ta dinte se ai e kishte dashur shumë. Julie Sweeney Roth më vonë e ndau mesazhin me publikun. Sot, kujtimi i tij ruhet edhe në Muzeun dhe Memorialin Kombëtar të 11 Shtatorit në Nju Jork.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[FOTOT/ Aksident i frikshëm i futbollistit të njohur, makina luksoze përmbysset në rrugë](#)

15:29 Lifestyle

[“Jemi vazhdimisht në një gjendje zie”/ Bashkëshortja e Bruce Willis rrëfen dhimbjen e jetës me sëmundjen e aktorit](#)

14:37 Lifestyle

[Elon Musk i shpall luftë dokumentarit për jetën e tij, avokati kërcënon producentët me gjyq](#)

13:07 Lifestyle

[Vdekja e Giorgos Mazonakis, kamerat zbulojnë një tjetër mister! Çfarë nuk përputhet në dëshmitë e mjekëve](#)

12:27 Lifestyle / 1 koment

[FOTO/ Bianca Censori habit me transformimin, flokë bjonde dhe të brendshme të arta në pozat e reja](#)

11:49 Lifestyle / 2 komente

[Angelina Jolie lë pas jetën në SHBA, aktorja zbulon planin e ri: “Dua të jetoj në mënyrë nomade”](#)

10:30 Lifestyle / 3 komente

[Fustani ikonik i Princeshë Dianës del në ankand! Veshja pritet të shitet deri në 300 mijë dollarë](#)

10:00 Lifestyle

["Di të gatuj groshë, specia me mazë", Bebe Rexha tregon në emisionin e famshëm amerikan recetat tradicionale shqiptare](#)

09:00 Lifestyle / 3 komente

[Shkencëtarët grekë ngrenë alarmin për trajtimet “kundër plakjes”: “Shkenca ka nevojë për prova, jo premtime”](#)

17:00 Lifestyle / 5 komente

[FOTOT/ Sydney Sweeney “tërbon” fansat me reklamën e re, shfaqet nudo dhe mbulohet me topa](#)

16:35 Lifestyle / 1 koment

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...](#)

09:45 Politika / 22 komente

[Fides në PD, Syri i Eka sumon Demin Kemajin: Ky mund po...](#)

15:45 Politika / 30 komente

[EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej “aferën e armëve” m...](#)

15:30 Dossier / 13 komente

[Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...](#)

13:04 Politika / 51 komente

[‘Kallëzim se po zbatoj ligjin’, ministri Malaj publikon p...](#)

19:05 Politika / 77 komente

Blog Tema

[Shteti i leshit dhe Republika e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve](#)

13:50 Blog / 12 komente

[Ministrja që Rama po kërkon](#)

12:40 Blog / 13 komente

[Demokracia, jo më si vlerë lirie](#)

12:30 Blog / 5 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

REGJISTROHU

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

- 
- 
- 
- 
- 

Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Turizëm](#)
 - [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Dossier](#)
 - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by